| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Edukimit** |
| **Titulli i lëndës:** | **Teoria e mësimit dhe kurrikula** |
| **Niveli:** | **MA** |
| **Statusi lëndës:** | **O** |
| **Viti i studimeve:** | **I** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3+0** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **5** |
| **Koha / lokacioni:** | **Vendi: Fakulteti i Edukimit - Prishtinë** |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Asst. Dr. Sc. Jehona Ferizi Miftari** |
| **Detajet kontaktuese:** | **Fakulteti i Edukimit, K i IV, Z 16**<br><br>**jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | *Kursi ofrohet për të promovuar bazën historike, filozofike e pedagogjike të procesit të nxënit dhe të mësimdhënies. Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkitazi me kompleksitetin e procesit të të nxënit, bazën filozofike, e sociale të të nxënit, teoritë e të nxënit, stilet e të nxënit. Gjithashtu studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë dhe qasjet kryesore kurrikulare dhe efektet e tyre në procesin e të nxënit dhe mësimdhënies së suksesshme dhe të promovojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ.* |
| **Qëllimet e lëndës:** | *Të përpunohen e të mbarështohet bashkërisht me studentë, të arriturat dhe perspektiva në fushën e mësimdhënies e të arsimit, në vend dhe më gjerë;*<br>*Të udhëzohen vijuesit në kërkimin e përmbajtjeve të reja të metodologjisë për mësimdhënie të suksesshme të mbështetura në Kornizën e Kurrikulit të Kosovës.* |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | *Studentët do të:*<br>• *shpjegojnë konceptet themelore në fushën e teorisë së mësimit;*<br>• *interpretojnë teoritë dhe stilet e ndryshyme të të nxënit dhe mësimnxënies*<br>• *analizojnë gjendjen e mësimdhënies në shkollat e Kosovës krahas teorive të ndryshme të mësimit;*<br>• *përshkrujnë dhe analizojnë zbatimin e stileve të ndryshyme të të mësuarit në punën e mësimdhënësit dhe arritjet e nxënësve duke respektuar parimin e diversitetit;*<br>• *demonstrojnë shkathtësi të zbatimit të strategjive të mësimdhënies bazuar në Kornizën e Kurrikulës të Kosovës;*<br>• *analizojnë teoritë e ndryshme kurrikulare dhe Kornizën e Kurrikulës të Kosovës e dokumentet tjera relevante;*<br>• *argumentojnë mësimdhënien bashkëkohore (përparësitë e teknikave ndërvepruese) në raport me mësimdhnien tradicionale.* |

| Kontributi në ngarkesën e studentit | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 3 | 3 | 9 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Pojekt | 1 | 8 | 8 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 10 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 7 | 14 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | | | 25 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 5 | 10 |
| Tjetër shëno: | 5 | 2 | 10 |
| **Totali** | | | **125** |

<table>
<tr><td>Metodologjia e mësimdhënies:</td><td>Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në cifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies</td></tr>
<tr><td>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:</td><td>Pjesëmarrja në mësim dhe angazhimi në ligjëratë 10 %<br>Detyrat, punimet në portfolio (google classroom) 15 %<br>Prezentimi/projekti 35%<br>Vlerësimi final 40 %<br><br>
<table>
<tr><td>Nota</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Përqindjet</td><td>55-60%</td><td>61-70%</td><td>71-80%</td><td>81-90%</td><td>91-100%</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td colspan="2">Literatura</td></tr>
<tr><td>Literatura bazë:</td><td>• Ligjërata e përgatitur nga mësimdhënësi, video/materialet në Classroom<br>• Grup autorësh. (2013). Mësimdhënia dhe të mësuarit: Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore.<br>• Illeris, K. (2007). How we learn: Learning and non-learning in school and beyond. Routledge.<br>• Ertmer, P. A., & Newby, T. J. (2013). Behaviorism, cognitivism, constructivism: Comparing critical features from an instructional design perspective. Performance Improvement Quarterly, 26(2), 43-71.<br>• Ko, J., Sammons, P., & Bakkum, L. (2016). Effective teaching. Oxford: Education Development Trust.<br>• Kay, D., & Kibble, J. (2016). Learning theories 101: application to everyday teaching and scholarship. Advances in physiology education, 40(1), 17-25.<br>• Marsh, C. (2009). Konceptet themelore për ta kuptuar kurrikulën. Neë York: Routledge. (Botuar në shqip në vitin 2014 nga CDE, Tiranë);<br>• MASHT. (2016) Kurrikulat Bërthamë (klasa VI deri IX dhe X deri XII).<br>• MASHT. (2016). Korniza e Kurrikulit të Kosovës(e rishikuar)<br>• Nishku, A. (1997). Kurrikuli në arsim. Tiranë.<br>• Orstein, A C. & Hunkins, F. P. (2003). Kurrikula, parimet dhe problemet.Tiranë: Instituti i Studimeve<br>• Schunk, D. H. (2012). Learning theories an educational perspective sixth edition. Pearson.<br>• USAID & AED. (2009). Krijimi i mjedisit për shekullin XXI. Shkup<br>• USAID & AED. (2009). Mësimdhënia dhe mësimnxënia në shekullin 21. Shkup<br>• Zylfiu, N. (2011). Teoria e mësimit dhe proceset didaktike të mësimdhënies (didaktika), Prishtinë<br>• Zhou, M., & Brown, D. (Eds.). (2017). Educational learning theories. https://oer.galileo.usg.edu/cgi/vieëcontent.cgi?article=1000&context=education-textbooks</td></tr>
<tr><td>Literatura shtesë[1]:</td><td>• Mato. E. Mita, N. Kamani, P. (2007). Filozofia e kurrikulës kombëtare të arsimit bazë. Tiranë.<br>• Mato, E. Mita, N. Kamani, P. (2007). Përqasje të kurrkulës në bazë shkolle. Tiranë.<br>• Monteiro, A. R. (2015). The teaching profession: Present and future. Dordrecht: Springer International Publishing.<br>• Sula, G. (2015). Të nxënët – nga teoria në praktikë. Tiranë: Kumi.<br>• Savage, J. (2019). Cross-curricular teaching and learning in the secondary school. Routledge.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Plani i dizejnuar i mësimit:</td></tr>
</table>

[1] Gjatë kursit studentët do të lexojnë edhe artikuj të sugjeruar shkencor dhe profesional nga fusha e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Njoftim me programin, obligimet, procesin e vlerësimit, literaturën. metodologjinë e mësimdhënies dhe propozime eventuale. |
| ***Java e dytë:*** | Të nxënit, përkufizimi, teoritë |
| ***Java e tretë*:** | Stilet e të nxënit |
| ***Java e katërt:*** | Mësimdhënia, specifikat dhe problemet e mësimdhënies<br>Menaxhimi i klasës |
| ***Java e pestë*** | Mësimdhënësi tradicionale dhe mësimdhënia bashkëkohore<br>Mësimdhënësi efektiv |
| ***Java e gjashtë*:** | Kuptime kryesore për kurrikulën; Përkufizimi i kurrikulës, konceptet për kurrikulën; Llojet e kurrikulës |
| ***Java e shtatë:*** | Karakteristika të filozofisë së re kurrikulare<br>-kurrikula e ndërtuar në bazë kompetencash<br>-kurrikula e përqëndruar në rezultatet dhe produktet e të nxënit<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e tetë:*** | Korniza e Kurrikulit të Kosovës<br>Kurrikula Bërthamë dhe Kurrikula zgjedhore<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e nëntë:*** | Aspekte të mësimdhënies dhe të nxënit sipas Kornizës së Kurrikulës së re të Kosovës<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| | Mësimdhënia dhe nxënia në fushat e ndryshme të kurrikulës<br>Çështje/temat ndërkurrikulare<br>Aktiviteteve jashtëkurrikulare<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e dhjetë:*** | Planifikimi i punës mësimore dhe elementet e planifikimit të mirë.<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | Taksonomia e Blumit dhe dizajnimi i rezultateve të nxënit<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Vlerësimi i bazuar në kompetenca<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Të nxënit me situata, konstruktivizmi dhe teknologjia<br>- *Prezentimet e punës hulumtuese të studentëve* |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Analizë e detyrave, vlerësimi i angazhimit dhe rezultatet e secilit vijues të kursit |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Analizë e programit, sygjerime për provim |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: |
|---|
| - Studenti që ka 3 mungesa pa arsye, konsiderohet se humb të drejtën për t'iu shtruar provimit<br>- Secili studentë ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala;<br>- Asnjëri nuk ka të drejtë t'i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën;<br>- Lejohet "zhurma" e punës kur studentët punojnë në grupe;<br>- Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimdhënësi apo prezentohet puna e studentëve;<br>- Nuk lejohen telefonat celularë;<br>- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme<br>- Dënohet cdo formë e kopjimit apo falsifikimit<br><br>**Përgjegjësitë e vijuesve të kursit:**<br>• Të sigurojnë literaturën e rekomanduar për lëndën.<br>• Të përgatiten rregullisht për pjesëmarrje aktive në ligjërata.<br>• Të respektojnë idetë e të tjerëve.<br>• Të përmbushin detyrimet e kursit në afatet e caktuara.<br>**Përgjegjësitë e mësimdhënësit**<br>• Të prezantojë rregullisht në ligjërata ose në raste të jashtëzakonshme kur mungon, të informojë paraprakisht vijuesit për mungesën dhe kohen e kompensimit të orëve.<br>• Të udhëheqë dhe moderojë me efikasitet debatet, prezantimet dhe diskutimet për përmbajtje të temave të kursit.<br>• Të monitorojë dhe vlerësojë angazhimin dhe rezultatet e secilit vijues të kursit.<br>• Të mbajë portfolion e angazhimit të vijuesve.<br>• Të përgatisë instrumente të vlerësimit përfundimtar. |